

PEDAGOGJIA E TRAJTIMIT AUTOMATIK TË GJUHËVE (PeTAG)

Janar 2022

PROGRAMI :

UT- KËRKIM, EKSELENCË, INOVACION

OBJEKTIVAT

Objektivi i përgjithshëm i projektit është krijimi i diplomës së dyfishtë në nivelin Master, e para në fushën e trajtimit automatik të gjuhëve.

Ky projekt ka si objektiva specifike :

- forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të ndërkombëtarizimit të universitetit,
- formimin e specializuar sikurse është trajtimi automatik i gjuhëve, krijimin dhe zhvillimin e studimeve ndërdisiplinare si dhe mësimdhënien në gjuhë të huaj, duke qenë se ky program do të ofrohet në gjuhën frënge dhe angleze.

REZULTATET

- Krijimi i diplomës së dyfishtë
- Formim ndërdisiplinar
- Program studimi që përshtetet me tregun e punës
- Forcimi i bashkëpunimit me universitetin partner
- Përfitimet nga programet Erasmus me Universitetin Sorbonne Paris Nord
- Pajisja me diplomë ndërkombëtare

Rëndësia e WEB Semantic në ndërtimin e korpuseve dhe në përkthimin e teksteve të specialitetit

Financuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Rëndësia e projektit

Duke parë ecurinë dhe kërkesat e tregut të përkthimit, kjo fushë është e rëndësishme sepse mundëson:

- një përkthim të qëndrueshëm dhe harmonizimin terminologjik,
- zvogëlon kostot,
- përshpejton dhe rrit produktivitetin e procesit të përkthimit.

Qëllimi

Qëllimi kryesor i studimit është të vërtetojë se aplikimi i teknologjisë në procesin e përkthimit të teksteve të specialitetit:

1. përmirëson cilësinë e përkthimit në kuadrin gjuhësor dhe terminologjik duke qenë se përkthimi në kontekst shmang paqartësitë leksikore, referuese, strukturore, semantike, pragmatike si dhe paqartësitë që lidhen me shprehjet idiomatike,
2. harmonizon terminologjinë,
3. ndihmon në krijimin e korpuseve njëgjuhëshe, shumëgjuhëshe dhe atyre paralele, të rëndësishme në procesin e përkthimit.

Objektivat

Objektivi i përgjithshëm i projektit është ndërtimi i një platforme “web semantic” e cila do të mundësojë krijimin e bazave të të dhënave. Këto baza të dhënash do të përdoren për qëllime të ndryshme studimore, në rastin tonë konkret për analiza semantike, sintaksore dhe terminologjike në funksion të përkthimit.

Objektivat specifikë të projektit :

- Përdorimi i një metodologjie të re të bazuar në trajtimin automatik të materialit me qëllim analizën e tij. (**Thelbi**: krijimi i bazave të të dhënave në fusha si *acquis communautaire*, letërsi apo fusha të tjera, u vjen në ndihmë analizave të ndryshme në funksion të përkthimit);
- Dimensioni digjital do të rikonceptojë metodat e mësimdhënies dhe të mundësojë aksesin në shumë mjete, burime dhe aplikacione;
- Forcimi i mësimdhënies në gjuhë të huaj si gjuhë e formimit të specializuar;
- Rritja e bashkëpunimit brenda në FGJH duke krijuar dhe zhvilluar paralelisht studime në më shumë se një gjuhë të huaj.

Përfituesit & rezultatet e pritshme

Përfituesit :

- Në nivel universitar : pedagogët, kërkuesit shkencorë, studentët e kryesisht të ciklit të dytë dhe të tretë të studimit.
- Në nivel kombëtar: institucionet që do të angazhojnë studentët në digjitalizimin e aktiviteteve të tyre; vënia në dispozicion të platformave, softwareve dhe produkteve që do të krijohen dhe realizohen në bashkëpunim me universitete partnere, me mbështetje të fondeve të BE-së, pas aplikimeve për t'i thithur ato.

Rezultatet e pritshme :

- Korpusi dhe metadata të cilat do të trajtohen nëpërmjet algoritmeve sipas qëllimeve dhe specifikave të ndryshme;
- Forcimi i bashkëpunimit midis doktorantëve dhe pedagogëve si dhe përdorimi i njohurive në funksion të objektivit të përgjithshëm.
- Publikimi i studimeve të përbashkëta dhe pjesëmarrja nëpër konferenca.